



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



**Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të
Pronës së paluajtshme Komunale
14 Nr. 01/14
Dt. 30.07.2014**

Në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, nr.125/14 datë 28.05.2014, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, më datë 30.07.2014, shpallë :

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË
PALUAJTSHME KOMUNALE**

Numri referues i shitjes: 644 – 14 – 001 – P.K.

NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri i AK	Komuna Vushtrri Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Personi kontakt:	Hyda Dallku , tel. 044 – 147 - 181 Iliriana Azemi, tel. 044 – 347 - 419
Adresa	Rr ”Adem Jashari “ nr.1	Kodi postar	42000
Qyteti	Vushtrri	Regjioni	Mitrovicë
Telefoni		Fax	
e-mail			

NENI II: LËNDA E ANKANDIT

Autoriteti kontraktues – Komuna e Vushtrrisë, në bazë të Vendimit nr. 125/14 datë 28.05.2014 të Kuvendit Komunal, ka përcaktuar si qëllim dhënien shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale personave Juridik dhe personave fizik, përmes ankandit publik, **procedura përmes ofertave të mbyllura.**

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si vijon :

1. Prona Komunale në rr. “ Adem Jashari “, në sipërfaqe të tërësishme prej 182m², Ngastra Kadastrale P-653, e cila ndahet në 14 parcela x 13m², për vendosjen e kiosqeve, në dimensione 2.6m x 5.0om.

2. Kriteri i Dhënies së Kontratës : Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë.
3. Çmimi fillestarë për m² është 2.00€.
4. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 5 vite me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite.
5. Veprimtaria që ushtrohet në hapësirat e dhëna në shfrytëzim është kryesisht veprimtari zejtare, artizanati, tregtare etj. Për më tepër informacione referoju Dokumentit të Ankandit, Pjesa XIII. Specifikimi i Çmimeve dhe Veprimtarive.

NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE

1. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit : data 27.08.2014 ora 15.00
2. Afati i kohorë për pranimin e Aplikacioneve: data 01.09.2014 ora 13.30. Vendi: Komuna Vushtrri, zyra nr. 1 kati i I-ë.
3. Takimi për hapjen e Aplikacioneve bëhet më datë 01.09.2014, ora 14.30, vendi : Salla e Kuvendit Komunal – Vushtrri.
4. Ofertat duhen dorëzuar të mbyllura. Për më tepër informacione, lexo me kujdes pikën VII të Dosjes së Aplikimi.
5. Numrat kontaktues : 044 – 147 – 181 dhe 044 – 347 - 419
6. E-maili :
7. Informacionet shtesë mundë ti kërkoni përmes përdorimit të formularit bashkangjitur Dosjes së Aplikacionit. Për më tepër informacione shiko pikën VI. të dokumentit të ankandit.
8. Tërheqja e aplikacionit mundë të bëhet në formë fizike dhe elektronike.

NENI IV: ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Vushtrrisë, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.